



STATUTI
I
LEVIZJES
PËR BASHKËVEPRIM

Dispozitat e përgjithshme:

- I. Parimet,**
- II. Akronimi-Simboli dhe selia,**
- III. Programi politik,**
- IV. Anëtarësia,**
- V. Organizimi,**
- VI. Struktura dhe vendimmarrja,**
- VII. Financimi,**
- VIII. Përfaqësimi,**
- IX. Komisionet,**
- X. Dispozitat kalimtare dhe zbatueshmëria,**
- XI. Arka,**
- XII. Arhiva.**

- I. Parimet**

Neni. 1

- 1.1 Lëvizja për bashkëveprim është Parti Politike e qytetarëve të Kosovës . Në veçanti i komunitetit ashkali, i njohur me këtë term edhe me Kushtetutën e Repepulikës së Kosovës, e cila aktivitetin e vet politik e zhvillon në bazë të programit, statutit dhe të dokumenteve të tjera të miratuara në Kuvend,
- 1.2 Lëvizja për bashkëveprim është e organizuar në baza vullnetare dhe promovon kulturën politike mbi të gjitha nevojat e komunitetit për një jetë më të mirë.
- 1.3 Lëvizja për bashkëveprim ngrit zërin qytetar dhe vihet në mbrojtje të interes të komunitetit ashkali.
- 1.4 Lëvizja për bashkëveprim kultivon politika të shëndosha mbi parimet e shtetndërtimit, lirisë, paqës, bashkëjetësës, barazisë gjinore, lirisë fetare, raporte të mira ndërnjerezore pa dallim ngjyre, rrase, përkatsis etnike.
- 1.5 Lëvizja për bashkëveprim kultivon politika pro Evropiane,
- 1.6 Lëvizja për bashkëveprim Bashkëpunon me partit tjera vendore për ta pasuruar programin politik për qeverisje të mirë .
- 1.7 Lëvizja për bashkëveprim veprimtarin e saj politike e ushtronë në tërë territorin e Kosovës dhe bashkëpunon ngusht me degët e saj në diasporë.
- 1.8 Lëvizja për bashkëveprim organizohet dhe vepron edhe jashtë Kosovës, në përputhshmëri me ligjet e shtetit ku vepron.
- 1.9 Lëvizja për bashkëveprim ka për qëllim konkurrimin politik në Kosovë përmes zgjedhjeve të lira dhe demokratike.
- 1.10 Lëvizja për bashkëveprim synon shtetin e së drejtës, sigurinë e individit dhe të pronës, përgjegjësinë individuale e fuqizimin e familjes, ruajtjen e natyrës dhe të ambientit.
- 1.11 Lëvizja për bashkëveprim angazhohet për integrimin e Kosovës në organizmat evropiane e euro - atlantike si dhe për një rrezatim pozitiv të imazhit të vendit kudo në botë.

- 1.12 Lëvizja për bashkëveprim bashkon rreth saj të gjithë qytetarët e Komunitetit ASHKALI që u përmbahen këtyre aspiratave dhe objektivave të parapara me platëform politike të Levizjes për bashkëveprim.
- 1.13 Lëvizja për bashkëveprim garanton shprehjen e lirë politike . Ajo bazohet në rrespektin e paritetit gjinor në jetën e Levizjes, dhe në pjesëmarrjet zgjedhore e ekzekutive.
- 1.14 Lëvizja për bashkëveprim synon që shteti i Kosovës të jetë shtet Ligjor të ndërtojë sistem gjyqësor të pavarur dhe professional.
- 1.15 Synon të ndërtojë një shtet demokratik për të gjithë në Kosovë të bazuar në kushtetutën e vendit.
- 1.16 Synon avancimin e të drejtave njerëzore të njohura ndërkombëtarisht.
- 1.17 Synon të ofrojë zgjidhje të gjitha tensioneve dhe urrejtjeve ndëretnike dhe religjioze duke luftuar të gjitha format e diskriminimeve në baza nacionale, religjioze, racore e gjinore të qytetarëve të Kosovës.
- 1.18 Synon respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave të garantuara me Kushtetutë,
- 1.19 Politika e Lëvizja për bashkëveprim përcaktohet dhe pasqyrohet në Programin e saj në përputhje me Statutin.

Neni. 2

Lëvizja për bashkëveprim është parti e qendrës me orientim socialdemokrat.

II. Akronimi-Simboli dhe selia

Neni. 3

Lëvizja për bashkëveprim në akronimin e saj përmban tri shkronja: **LpB.**

Neni. 4

LpB do të ketë simbolin e saj të cilën do ta miratoj këshilli i përgjithshëm,

Neni. 5

Levizjes për Bashkëveprim do të ketë vulën e saj dhe vulën për protokol.

- 5.1 LpB në vulën e saj do të ketë : në mesin e saj hartën e Kosovës, shkurtesa e emrit të parties (akronimi), dhe në rrethin e saj emrin e plotë të Levizjes për Bashkëveprim .
- 5.2 Forma e vulës do të jetë e rrumbullakët.
- 5.3 Vula e protokolit do të ketë formën katërkëndshe.

Neni. 6

LpB për selin e saj e .vendos këshilli i përgjithshëm.

III. Programi politik

Neni. 7

- 7.1 Programi politik bazohet në nevoja të qytetarve dhe zhvillimeve politike të kohës së saj.
- 7.2 Draftohet dhe miratohet brenda organeve të **LpB-së**,
- 7.3 Programi politik është i hapur për publikun.
- 7.4 Programi politik nuk cenon të drejtat dhe lirit e të tjerve, por përmbahet ligjeve të Republikës së Kosovës, në përputhje me statutin e **LpB-së**,
- 7.5 Akti normativ më i lartë brenda Lëvizja për Bashkëveprim është Statuti i saj,
- 7.6 Të gjitha aktet tjera normative duhet të jenë në përputhje me Statutin,

- 7.7 Programi i Levizjes për bashkëveprim është në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Kosovës.

IV. Anëtarsia

Neni. 8

- 8.1 Anëtarsimi në Lëvizjen për Bashkëveprim është i lire në vullnetin e vetë qytetarëve të Kosovës dhe të Komunitetit në Diasporë,
- 8.2 Anëtarë i Levizjes për Bashkëveprim mund të bëhet qdo qytetar i cili e ka moshën 18 vjeqare dhe i cili pranon dispozitat e këtij Statuti, Platëformës, Programit dhe akteve të tjera normative të Levizjes për Bashkëveprim,
- 8.3 Anëtarsim në **LpB** ka të drejtë qdo qytetarë që ka shtetësinë e Kosovës qoftë edhe banorë i përkohëshëm jashtë Kosovës,
- 8.4 Qdo anëtarë duhet të nënshkruajë deklaratën, apo fletë-anëtarësimin në Lëvizjen për Bashkëveprim.
- 8.5 Anëtari i Levizjes për Bashkëveprim duhet të mbrojë, dhe të promovojë politikat e Levizjes për bashkëveprim në të gjitha format e organizimit, dhe të veprimet politik.
- 8.6 Anëtari i Levizjes për Bashkëveprim nuk mund që njëkohësisht të jetë edhe anëtarë i ndonjë subjekti tjetër politik.
- 8.7 Qdo anëtar i cili dëshiron të antarësohet duhet tu nënshtrohet procedurave të pranimit.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve

- 9.1 Secili anëtar i Levizjes për Bashkëveprim i ka këto të drejta dhe obligime:

- 9.2 Të marrë pjesë në përcaktimin dhe në realizimin e politikave të Levizjes,
- 9.3 Të ndërmarrë nisma që janë në pajtim me Statutin dhe Programin e Lëvizja për bashkëveprim dhe t'ua prezantojë organeve vendimmarrëse,
- 9.4 Të zgjedhë dhe të zgjedhet në organet e Lëvizja për bashkëveprim,
- 9.5 Të të shprehë mendimin e vet në suazat e Levizjes,
- 9.6 Të angazhohet në fushatën zgjedhore për sukses të Levizjes në zgjedhje,
- 9.7 Të paguajë anëtarësinë, (jo obligativ për qytetarët në Kosovë),
- 9.8 Anëtari ka të drejt të zgjedhë, dhe të zgjedhet në organet e **LpB-së**.
- 9.10 Anëtari ka të drejtë të kandidoj në zgjedhjet lokale dhe nacionale të Kosovës, me vendim të organeve të **LpB-së**.
- 9.11 Të propozohet si kandidat i Levizjes për Bashkëveprim në listat zgjedhore për zgjedhje Lokale, Parlamentare apo Presidenciale,
- 9.12 Të jetë i informuar me kohë për punën e organeve të Levizjes për Bashkëveprim,
- 9.13 Të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet përkatëse të Lëvizja për Bashkëveprim,
- 9.14 Të përhap, të mbroj, dhe të propagandojë përcaktimet Programore dhe qëndrimet politike të Levizjes,
- 9.15 Të realizojë të drejtat dhe të përmbushë obligimet tjera të parapara me Program, me Statut dhe me akte e vendime të tjera.

Neni.10

Humbja e anëtarësisë

- 10.1 Me dorëheqje vullnetare,
- 10.2 Në rast përjashtimi nga ana e organeve të Levizjes për Bashkëveprim,

- 10.3 Nëse e humb aftësinë e plotë të veprimit,
- 10.4 Anëtari humb anëtarësimin në **LpB** me anëtarësim në parti tjetër,
- 10.5 Anëtari që humb anëtarësimin në **LpB** me vendim për përjashtim, ka të drejtë ankese në organet e caktuara të **LpB-së**.
- 10.6 Anëtari që humbë anëtarësimin në **LpB** nuk ka të drejtë të veproj në emër të **LpB – së** dhe të mbaj në pronsi dokumentet e fituara për kompetenc jashtë LpB-së.
- 10.7 Kërkesa për dorëheqje nga anëtarësia në **LpB** i drejtohet Kryesisë së Këshillit vendor,
- 10.8 Anëtari përjashtohet nga Lëvizja kur e shkel Statutin ose Programin e Levizjes, bën keqpërdorim e mjeteve financiare, dhe kur me veprimet e tij e dëmton prestigjin e Levizjes,
- 10.9 Pas përjashtimit, ose tërheqjes së anëtarit, largimi evidentohet në regjistrat bazë të Levizjes për Bashkëveprim.
- 10.10 Anëtari i përjashtuar me vendim, mund të ankohet në organet qendrore të
- 10.11 Levizjes për Bashkëveprim, përkatësisht Këshillit Drejtues, ose në Kryesinë e Lëvizja për bashkëveprim në afat prej 8 (tetë) ditësh nga momenti i marrjes së vendimit.
- 10.12 Anëtari që humbë anëtarësimin në **LpB** nuk ka të drejtë të veproj në emër të **LpB – së**, dhe të mbaj në pronsi dokumentet e fituara për kompetenc jashtë **LpB-së**.

V. Organizimi

Neni. 11

- 11.1 Lëvizja për Bashkëveprim është e organizuar në baza vullnetare.
- Lëvizja për Bashkëveprim qdo katër vjetë organizon Kuvend zgjedhor, dhe në mes kuvendeve zgjedhore organizon Kuvend pune (vlen për nivelin qëndror).
- 11.2 Lëvizja për Bashkëveprim organizon kuvend të jashtëzakonshëm kur strukturat e saja e vlersojnë si të nevojshme.
- 11.3 Lëvizja për Bashkëveprim organizohet nga strukturat e anëtarve të bashkësive të vogla (vendbanime me mbi 10 shtëpi, lagje, fshatra) që do të formojnë nëndegë, ku paraprakishtë marrin pëlqimin për mbajtjen e kuvendit nga organet e Lëvizjes për Bashkëveprim.
- 11.4 Lëvizja për Bashkëveprim organizohet në qdo komun ku së paku ka dy nëndegë, dhe do të formoj degë, me mbajtje të kuvendit të degës.
- 11.5 Lëvizja për Bashkëveprim nga degët në Kuvendet e saja bëjnë përzgjedhjen e delegatëve për Kuvend qëndror, me numër të rekomanduar nga Lëvizja për Bashkëveprim, e cila bazohet në numrin e banorve rezident, dhe numërin e anëtarve të vetë.
- 11.6 Lëvizja për Bashkëveprim organizon edhe mërgatën në diaspor, me kërkesën e tyre në shtetin ku jetojnë përkohësishtë, të cilëve ju mundsohet formimi i degës në shtetin përkatës duke rrespektuar ligjet në fuqi të shtetit ku jetojnë në diasporë, me bekimin e organeve dhe strukturave të Lëvizja për Bashkëveprim.
- 11.7 Lëvizja për Bashkëveprim – Kryesija e **LpB** harton plan programin e punës vjetore, ku për realizimin, apo ngecjen e përmbushjes së plan programit raportonë me shkrim te të gjitha degët në qdo gjashtëmujor.

Neni. 12

Kuvendi

- 12.1 Kuvendi qendror i Levizjes për Bashkëveprim do të ketë së paku 101 delegatë.
- 12.2 Kuvendin do ta udhëheq grupi punues i përbërë prej 5 anëtarve, deri në zgjedhjen e kryetarit të saj.
- 12.3 Kuvendi miraton dokumentet bazë të funksionimit të saj, grupin punues dhe aprovon Statutin me votim të thjeshtë.
- 12.4 Kuvendi zgjedhë Kryetarin e saj, Këshillin e përgjithshëm dhe komisionin statutar.
- 12.5 Kuvendi zgjedhë kryetarin e Partis me votim të lirë demokratik (votim i fshehur).
- 12.6 Kuvendi vendos për mënyrën e votimit nëse nuk ka më shumë se një kandidat për kryetar.
- 12.7 Nëse janë më shumë se dy kandidat, votimi konsiderohet i përfunduar nëse njëri nga kandidatët merr 50%+1 e votave të kuvendit për kryetar.
- 12.8 Nëse nuk zgjedhet kryetari me më shumë se dy kandidat, atëhere dy më të votuarit shkojnë në rivotim, dhe në rivotim me shumicë votash zgjedhet kryetari i Levizjes për Bashkëveprim.
- 12.9 Mënyra e zgjedhjes së kryetarit është e njejtë për të gjitha Kuvendët (Kuvendit Qendror, Degë, dhe Nëndegë).
- 12.10 Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta ftoj këshilli I përgjithshëm në mungesë të kryetarit, me vendimin e saj, i votuar me 50%+1 të këshillit përgjithshëm , atëher kur kryetari nuk sillet konform statutit, nuk përfill rekomandimet e këshillit të përgjithshëm apo ai nuk është I aftë për ta udhëhequr më tutje.
- 12.11 Qdo i zgjedhur në strukturën udhëheqëse, shkarkohet nga po ai organ i cili e ka zgjedhur.

Neni 13

Dega

- 13.1 Kuvendi i degës përbëhet nga delegatët e së paku dy nëndegëve.
- 13.2 Kuvendi i degës së Levizjes për Bashkëveprim do të ketë së paku 51 delegatë.
- 13.3 Kuvendi i degës e zgjedhë Kryetarin e degës, këshillin e degës dhe zgjedhë delegatët për kuvend qendror të Levizja për Bashkëveprim.

Nëndega

- 13.4 Kuvendi i nëndegës Levizjes për Bashkëveprim zgjedhë Kryetarin e saj, këshillin e nëndegës dhe delegatët për Kuvend dege.
- 13.5 Kuvendi I nëndegës i Levizjes për Bashkëveprim do të ketë së paku 21 delegatë.

VI Struktura dhe vendimmarrja

Neni. 14

Lëvizja për bashkëveprim ka strukturën udhëheqëse:

14.1 Udhëheqësia e strukturave Qëndrore:

- Kryetari i zgjedhur nga kuvendi.
- Këshilli i përgjithshëm i zgjedhur në kuvend.
- Kryesia e zgjedhur nga Këshilli i përgjithshëm.
- Kryesia në strukturën e saj do ta ketë edhe përfaqsimin nga diaspora.
- Të propozuarit nga diaspora do të marrin pëlqimin e këshillit të përgjithshëm.
- Në diasporë duhet të regjistrohet shoqata e Levizjes për Bashkëveprim me të gjitha aktet normative për oraginizimin e sajë.
- Sekretari i përgjithshëm i zgjedhur nga këshilli i përgjithshëm.

- Sekretari organizativ i zgjedhur - emëruar nga kryesia.
- Sekretari për marrëdhënie me publikun i zgjedhur -emëruar nga kryesia.
- Anëtarët e kryesisë të zgjedhur nga Këshilli i përgjithshëm.
- Arkatari i zgjedhur nga Këshilli i përgjithshëm.

14.2 Komisionet funksionale të zgjedhura nga Këshilli i përgjithshëm,

- Komisioni dicitplinor.
- Komisioni Financiar
- Auditori i mbrendëshm

14.3 Organizimi i degës në nivel të Levizjes për Bashkëveprim

- Kryetari i zgjedhur nga kuvendi i degës.
- Këshilli i degës i zgjedhur nga kuvendi.
- Kryesia e zgjedhur nga këshilli i degës.
- Nënkryetarët të zgjedhur nga këshilli i degës
- Sekretari i zgjedhur nga këshilli i degës.
- Anëtarët e kryesis të zgjedhur nga këshilli i degës.
- Arkatari i zgjedhur nga këshilli i degës.

14.4 Udhëheqësi e Nëndegës:

- Kryetari i zgjedhur nga Kuvend.
- Këshilli i nëndegës i zgjedhur në Kuvend.

- Kryesia e zgjedhur nga Këshilli i Nëndegës.
- Sekretari i zgjedhur nga Këshilli i Nëndegës.
- Arkatari i zgjedhur nga Këshilli i Nëndegës.

14.5 Forumet

- Udhëheqësia e forumit rinor - zgjedhet me Kuvend rinor.
- Udhëheqëse e forumit të gruas - zgjedhet nga Kuvendi i grave.
- Forumet do të organizohen në formen e Kuvendeve të ngjajshëm lokal dhe qëndrore si formimi i Levizjes për Bashkëveprim.

Neni. 15

Vendimet në Lëvizjen për Bashkëveprim:

- 15.1 Vendimet që do të marren në organet e Levizjes për Bashkëveprim, do të merren me votim të thjeshtë 50% + 1.
- 15.2 Detyrat dhe përgjegjësit e secilit organ do të rregullohen me rregullore të aprovuara nga Këshillin e përgjithshëm të Levizjes për Bashkëveprim, duke u përshtatur me ligjet e aplikushme në Kosovë, statutin dhe programin e Levizjes për Bashkëveprim.

VII. Financimi

Neni. 16

Lëvizja për Bashkëveprim mbështetet në burimet financiare :

- 16.1 Nga anëtarësia e saj, sipas ligjit për financimin e subjekteve politike.
- 16.2 Fondi për financimin e partive politike nga buxheti i Republikës së Kosovës.
- 16.3 Donatorët e mundshëm vendor, dhe atë ndërkombtare.
- 16.4 Lëvizja për Bashkëveprim do të ketë llogarin bankare në Kosovë .
- 16.5 Në rast të shpërbërjes së parties, pasuria e saj do të ndahet në shkolla apo shoqëri civile e cila punon për minoritar .
- 16.6 Në rast të shpërbërjes së parties borgji i mundshëm i krijuar mbetet në përgjrgjësi të kryetarit dhe kryesisë.

VIII. Përfaqësimi

Neni. 17

- 17.1 Lëvizja për Bashkëveprim në forumet politike përfaqshohet nga Kryetari, apo i autorizuari nga Kryetari me shkrim.
- 17.2 Përfaqsesi i Levizjes për Bashkëveprim në KQZ-ë, është sekretari i përgjithshëm.
- 17.3 I zgjedhuri nga zgjedhjet lokale apo qendrore, do të përfaqsoj Lëvizjën për Bashkëveprim, dhe do të veproj sipas delegimit të Levizjes për Bashkëveprim duke u përmbajtur Platëformës dhe programit politik.

- 17.4 Prezentimi I Levizjes për Bashkëveprim në emisione mediale, tryeza, apo takime të ngjajshme, gjithmon do të prezentohet me emrin e plotë Lëvizja për Bashkëveprim .
- 17.5 Postet politike në qeveri, Lëvizja për Bashkëveprim do ti nominoj me shumicë votash të Këshillit të përgjithshëm.

IX. Komisionet

Neni. 18

- 18.1 Lëvizja për Bashkëveprim ka komisionet e veta të cilat kanë mandatë të barabartë me statutin e Levizjes për Bashkëveprim.
- 18.2 Komisioni Statutar propozohet, dhe votohet nga kuvendi zgjedhor i Levizjes për Bashkëveprim.
- Komisioni statutar është organ mbikqyrës i statutit dhe zgjidhë kontestet në lidhje me interpretimin e saj brenda partisë.
- 18.3 Komisionet funksionale i formon këshilli I përgjithshëm.
- Komisioni dicitlinor.
 - Komisioni financiar.
 - Komisionet tjera të nevojshme sipas nevojës së kohës që I parasheh këshilli I përgjithshëm.

X. Dispozitat kalimtare dhe zbatueshmëria

Neni. 19

- 19.1 Parimishtë dispozitat e përgjithshme janë të zbatueshme në afat brenda gjashtëmuajve, deri në miratimin e saj në kuvend.
- 19.2 Me miratimin e dispozitave nga kuvendi, hyn në fuqi zbatueshmëria e dispozitave në statut.
- 19.3 Statuti është akti më i lartë juridik Levizjes për Bashkëveprim.
- 19.4 Kuvendi është organi më i lartë legjislativ i Levizjes për Bashkëveprim.
- 19.5 Të zgjedhurit në Kuvend marrin në përgjegjësi zbatueshmërinë e statutit.
- 19.6 Kryetari dhe Këshilli i përgjithshëm janë të obliguar ti hartojn, dhe ti miratojnë rregullat mbi funksionimin e strukturës së zgjedhur nga Këshilli i përgjithshëm, dhe funksionimin e Degëve, duke rrespektuar dispozitat ligjore.
- 19.7 Këshilli i përgjithshëm merrë vendim për hapjen e ëeb faqes dhe mirmbajtësit të saj.

XI. Arkatari dhe arka e Levizjes për Bashkëveprim.

Neni. 20

- 20.1 Arkatari i zgjedhur nga Këshilli i përgjithshëm është personi i vetëm përgjegjës për punë me mjete materiale (para) për të gjitha pagesat, dhe ruajtjen e mjeteve materiale në vende të sigurta.
- 20.2 Për keqpërdorim të këtyre mjeteve nga ana e arkatarit do të kërkohet përgjegjësi penale, dhe kompenzim i këtyre mjeteve.
- 20.3 Arkatari është individ i vetëm që ka përgjegjësi për xhirollogarin e Levizjes për bashkëveprim.
- 20.4 Arkatari i emëruar - zgjedhur nga Këshilli i përgjithshëm është i obliguar që Kryesisë së Levizjes për Bashkëveprim ti raportoj me shkrim mbi gjendjen materiale të Partisë mbi hyrjet dhe daljet e mjeteve materiale.

XII. Arhiva dhe sistemimi i dokumentacioneve:

Neni. 21

- 21.1 Sekretari i përgjithshëm i zgjedhur nga Këshilli i përgjithshëm është i obliguar që në emër të subjektit politik Lëvizja për Bashkëveprim të kujdeset mbi ligjëshmërin, dhe aprovimin e të gjitha akteve normative Juridike të Levizjes për Bashkëveprim.
- 21.2 Sekretari i përgjithshëm kujdeset për afatet e dërgimit të shkresave, formulimin, drejtëshkrimin, përkujdesjen e vulave, dhe dokumentave tjerë relevante.
- 21.3 Dhe për të gjitha shkeljet ligjore me kohë, dhe me shkrim ta njoftoj Kryesin e Levizjes për Bashkëveprim dhe komisionet funksionale.
- 21.4 Kordinon punët me Sekretarët tjerë të Degëve, Nëndegëve, të Diasporës dhe Shoqatës të Levizjes për bashkëveprim me seli në Diasporë,
- 21.5 Mos ndërrmarrja e këtyre masave pasojat do ti bartë Sekretari i përgjithshëm në rast të dëmeve materiale, apo penale,
- 21.6 Sekretari i përgjithshëm kujdeset edhe për formimin e evidencave dhe këtë:
- Të antarësis,
 - Strehimin dhe ruajtjen e të gjitha dokumentacioneve të arritura, apo të dërguara.
 - Kujdeset për librin e protokollit të gjitha shkresave të dërguara nga ana e Lëvizjes për bashkëveprim.
 - Kujdeset për librin e protokollit të gjitha shkresave të dorëzuara.
 - Kujdeset për librin e protokollit të gjitha shkresave të arritura.
 - Kujdeset për afatet ligjore të gjitha shkresave.
- Në arhivimin dhe përbujtjen e këtyre shkresave ka qasje vetëm Sekretari i përgjithshëm.

VV

Kryetari I LpB-së